



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 81/5 Prot

Tiranë, më 27.2.2017

VENDIM

Nr. 38, datë 27.2.2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit Nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "CCL Albania" sh.p.k. Tiranë, me aktivitetin e tij në formën ligjore person juridik,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.13 datë 16.01.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për kryerjen e hetimit administrativ, më datë 19.01.2017 e në vazhdim, grupi i inspektimit filloi procesin e hetimit administrativ pranë kontrolluesit "CCL Albania" sh.p.k. Tiranë, me objekt:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "CCL Albania" sh.p.k. Tiranë.

Në datë 19.01.2017, grupi i kontrollit komunikoi me përfaqësuesit e kontrolluesit, mbi detyrimin për zbatim të Urdhrit Nr.13 datë 16.01.2017 të Komisionerit.

"CCL Albania" sh.p.k. Tiranë, sipas ekstraktit nga regjistri tregtar për të dhënat e subjektit, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të aktivitetit: Shërbime Call Center, aktivitetet i telemarketingut (web call center), shitje online etj. Data e themelimit është 01.08.2013, me NIPT L32005015V.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi ka rregullore për sigurinë e informacionit e të të dhënave.
2. Kontrolluesi ka pajisur punëmarrësit me deklarata konfidencialiteti.

3. Kontrolluesi ka vendosur në hyrje të ambienteve tabela informuese mbi prezencën dhe monitorimin e tyre nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
4. Kontrolluesi ka kryer detyrimin për njoftim.
5. Kontrolluesi nuk ka marrë pëlqimin e rreth 80 punonjësve për monitorimin e tyre gjatë orarit të punës, nëpërmjet sistemit të kamerave vëzhguese (CCTV).
6. Kontrolluesi nuk ka të publikuar politikat e privatësisë, në portalin: www.ccl.al - <http://al.albaniancallcenter.com>.
7. Kontrolluesi nuk ka deklaruar përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-vëzhgimit (CCTV) si dhe përhapjen e të dhënave drejt institucioneve private apo shtetërore, në njoftimin e kryer pranë Zyrës së Komisionerit më datë 21.04.2014.

Konstatimet e pikës 5 (pesë), 6 (gjashtë) dhe 7 (shtatë) të këtij proces verbali përbëjnë shkelje administrative të nenit 5, 6, 18 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit Nr.3 datë 05/03/2010 të Komisionerit, mbi “Përpunimin e të Dhënave Personale me Sistemin e Video Survejimit në Ndërtesa dhe Mjedise të tjera”.

Në cilësinë provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

1. Kontratë me punëmarrësin.
2. Rregullore bazë e funksionimit të kontrolluesit “CCL Albania” sh.p.k. Tiranë.
3. Rregullore e brendshme e funksionimit të kontrolluesit “CCL Albania” sh.p.k. Tiranë.
4. Fotografji nga ambjentet e kontrolluesit, të cilat janë nën mbikëqyrjen e sistemit të video-vëzhgimit (CCTV).
5. Rregullore për sigurinë e informacionit dhe të të dhënave.
6. Ekstrakt i Q.K.B.-së.
7. Formular Njoftimi.
8. Deklarata Konfidencialiteti.
9. Printime nga ndërfaqja e sistemit i cili menaxhon listën e klientëve.
10. Formular për regjistrimin e klientëve Italianë.
11. Printim i listës së klientëve.
12. Printime nga sistemi i video-vëzhgimit (CCTV).
13. Printim të e-Mailit që komunikon listën e qytetarëve Italianë, të cilët kanë refuzuar marrjen e thirrjeve telefonike të pakërkuara (do not call register).
14. Printim nga portali i kontrolluesit: www.ccl.al; <http://al.albaniancallcenter.com>.

Pas përfundimit të hetimit administrativ, u mbajt procesverbali konform kërkesave të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” datë 30.04.2015.

Përfaqësuesit e kontrolluesit pasi u njohën me konstatimet e grupit të kontrollit, u shprehën si më poshtë:

“Përfashtoj pikën 5, pasi në hyrje të ambientit të punës ka shenja dalluese që tregojnë se ambienti survejohet me kamera.

Sistemi online i www.idp.al, ka pasur probleme me “reset password” dhe si pasojë nuk kemi përmbushur pikën 7, pasi kamerat janë instaluar së fundmi”.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” datë 30.04.2015, kontrolluesi është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancën dëgjimore që do zhvillohëj në datë 08.02.2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar. Përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimet si më poshtë:

- 1) “Në mbështetje të nenit 11 të Kodit të Punës, shoqëria ka miratuar një rregullore ku janë të shprehura ndër to edhe që ambjenti survejohet nga kamera për arsye sigurie, kjo rregullore është parashkruar edhe te kontrata e punës ku çdo punonjës duhet të respektoj e të lexojë rregulloren e brendshme të kompanisë. Gjithashtu gjatë plotësimit të formularit të intervistës me të dhënat personale, çdo punonjës firmos për pjesën e rënies dakord të përpunimit e të dhënave personale.*
- 2) Janë marrë masat e duhura për publikimin e politikave të privatësisë.*
- 3) Është provuar nga ana jonë të uploadohet formulari në sistem të www.idp.al, sistemi na ka rezultuar me probleme etj”.*

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi pretendimet e mësipërme shprehet:

Në lidhje me pikën 1 të pretendimeve:

- Zyra e Komisionerit ju bën me dije se, kontrolluesi gjendet në kushtet e pikës 3, gërma “b”, sipas së cilës citohet:

“3. Përpunimi i të dhënave personale me anë të një sistemi video survejimit është i ligjshëm:

b) me pëlqimin e subjektit të të dhënave, por praktikisht kjo është e mundshme vetëm në raste shumë të kufizuara, atëherë kur identifikimi i një grupi personash që janë brenda zonës së kamerës bëhet në mënyrë të qartë.”
- Zyra e Komisionerit gjithashtu, citon nenin 10 të Kontratës Individuale të Punës, (Mbrojtja e të dhënave personale), që kontrolluesi “CCL Albania” sh.p.k. lidh me punëmarrësit:

“10.1. Duke firmosur këtë kontratë ju pranoni që “CCL Albania” sh.p.k., ka të drejtë t’ju filmojë gjatë orarit të punës. Këto filmime bëhen vetëm për arsye sigurie. Kamerat nuk monitorohen në kohë reale por regjistrojnë të dhëna të cilat aksesohen vetëm në rastet kur është e nevojshme. Këto filmime konfidenciale mbahen dhe nuk shpërndahen me asnjë palë të tretë. Vetëm institucionet shtetërore kanë të drejtë të kërkojnë filmimet e kamerave dhe kjo vetëm nëse kërkesa e tyre përbën detyrim ligjor i cili duhet përmbushur.

10.2. Shpërndarja e imazheve dhe videove në rrjetet sociale.

“CCL Albania” sh.p.k., ka të drejtë të shpërndajë dhe të publikojë imazhe të stafit në rrjetet sociale etj”.

Në këtë rast, punëmarrësi kushtëzohet para firmosjes së kontratës, dhe i gjendur para këtij fakti, detyrohet të pranojë këtë nen të saj, ndërsa mekanizmi i “Pëlqimit”, sipas nenit 3, pika 24, i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, citon:

“24. “Pëlqimi i subjekteve të të dhënave” është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qënë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij”.

Në lidhje me pikën 2 të pretendimeve:

Zyra e Komisionerit, vlerëson faktin se kontrolluesi “CCL Albania” sh.p.k., ka reaguar në mënyrë të menjëherëshme duke rikuperuar konstatimin e grupit të kontrollit, për sa i përket përfshirjes së rubrikës së politikave të privatësisë në faqen zyrtare të kontrolluesit.

Në lidhje me pikën 3 të pretendimeve:

Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, nuk përjashton alternativat mbi përditësimet në formularin e njoftimit. Përveç postës elektronike, sistemit të regjistrimit në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit, është shërbimi postar apo dhe protokollimi i procesit pranë kësaj zyre.

Zyra e Komisionerit, vlerëson faktin që, kontrolluesi “CCL Albania” sh.p.k. Tiranë, ka reaguar duke siguruar pëlqimin e punëmarrësve mbi vëzhgimin e tyre me kamera survejuese gjatë kohës së punës, si dhe ka rikuperuar gjetjet e tjera.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit konkludon se, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 pika 1, gërma “a” të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbëjnë “kundërvajtje administrative”, e cila sanksionohet me gjobë si më poshtë:

“1.Rastet e përpunimit të të dhënave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen më gjobë, si më poshtë:

a) Kontrolluesit që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;”.

Kontrolluesi “CCL Albania” sh.p.k. Tiranë, në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën I të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh faktin se, shkeljet e konstatuara konsistojnë në moszbatim të ligjit, akteve nënligjore dhe parimeve bazë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ato lidhen me cënimin e sigurisë së të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kryesisht për kategorinë "punëmarrës".

Gjithashtu, në zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5 dhe 6, Kreu II, neni 39 pika 1, gërma "a", neni 39, pika 2 e Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të Komisionerit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "CCL Albania" sh.p.k. Tiranë, me gjobë në vlerën **30.000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 5 dhe 6, kreu II të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 27. 2.2017.

